

THE AFRICAN – LE CLÉZIO AUTOBIOGRAPHICAL NOVEL *AFRIKANI ROMAN AUTOBIOGRAFIK I LE CLÉZIO-SË*

Besa SALIU¹, Shejnaze AJDINI-MURTEZI²

¹High School of Music „Todor Skalovski - Tetoec“ - Tetovo

² Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians - Skopje

*Corresponding author e-mail: besasaliu@hotmail.com

Abstract

The African novel presents a biography of his father related to a memorial work about Africa where Le Clézio lived during his childhood, the writer begins a real investigation into his origins. To make this novel more accessible to the reader, he presents his story with images, about fifteen photographs that are selected from his father's collection. This picture depicts his life and his sufferings in Africa, or more easily with pictures than with words. Therefore, Le Clézio in this novel describes a memory that is not only his, but is also the memory of the time that preceded his birth. The myth that follows him through the narrative and the story of his life once emerges as a problematic, and often mysterious, game between text and images.

Keywords: *The African, biography, Le Clezio, history.*

Përmbledhje

Romani *Afrikan* paraqet një biografi të babait të tij lidhur me një vepër kujtese për Afrikën, aty ku Le Clézio e kaloi fëmijërinë e tij. Këtu shkrimtari fillon një hetim të vërtetë për origjinën e tij. Për ta bërë këtë roman më të kapshëm për lexuesin, ai e paraqet historinë e tij me imazhe, gjegjësisht me pesëmbëdhjetë fotografi, të zgjedhura nga koleksioni i babait të tij. Këto fotografi paraqesin jetën dhe vuajtjet e tij në Afrikë, e cila kuptohet më mirë më lehtë me fotografi sesa me fjalë. Pra, në këtë roman, Le Clézio përshkruan një kujtim që nuk është vetëm i tij, por është edhe kujtimi i kohës që i paraprin lindjes së tij. Miti që e ndjek gjatë rrëfimit dhe historia e jetës së tij dalin, herë-herë, si një lojë problematike, dhe më shpesh misterioze, midis tekstit dhe imazheve.

Fjalët kyçe: *Afrikan, biografi, Le Clézio, histori.*

1. Hyrje

Afrikan (L'Africain) është roman autobiografik i cili u botua në vitin 2004. Është vepër autobiografike, në të cilën Le Clézio e përshkruan fëmijërinë e tij afrikane dhe figurën e babait të tij. (Clézio, 2006, 6). Pas një fëmijërie të kaluar në Nicë së bashku me gjyshërit e tij të nënës dhe me nënën e tij, nën ethet e Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1948, familja e tij vendoset në Nigeri. Në atë kohë ai kishte vetëm tetë vjet. Shtëpia e tij në Afrikë, në Ogoja, ishte një kasolle çimentoje me dekorim joekzistent, pa rehati. Nga njerëzit përreth tij, ai së pari sheh kufomat dhe trupat e zhveshur të fëmijëve. Le Clézio nuk do ta gjejë kurrë një liri të tillë: të largohet nga shtëpia gjatë ditës, të vrapojë me vëllain e tij dhe fëmijët e zinj drejt fushës së madhe të barit.

2. Romani Afrikani

Në këtë vepër autobiografike, Le Clézio përshkruan fëmijërinë e tij të cilën e kaloi në kontinentin afrikan dhe njëkohësisht figurën e babait të tij si një mjek udhëtar në Afrikën Perëndimore. Romani është i ndarë në shtatë pjesë ku përshkruhet jeta dhe vendet që ai i kishte kaluar në Afrikë (Cortanze, 2004, 68-70). Në pjesën e parë të romanit të emërtuar *Trupi*, autori rrëfen kohën kur kishte jetuar në Afrikën Perëndimore, përkatësisht në Nigeri, së bashku me nënën dhe babain e tij, që ishin të vetmit evropianë në atë rajon.

Ata jetonin në një kasollë që ishte e mbuluar me llamarinë, që nuk kishte as pasqyrë, pa asnjë zbulurim, thjesht ishin katër mure të pasuvatuara, një dysHEME çimentoje dhe e vetmja gjë apo luks ishte një dush i lidhur nëpërmjet tubash hekuri me një cisternë që ngrohej nga dielli mbi çati (Clézio, 2009, 8). Kjo pjesë që titullohet *Trupi* paraqet shfaqjen e trupave në memorjen e Le Clézio-s së vogël. Ai e sheh së pari trupin e vet, të nënës, vëllait, djemve përreth, trupin e femrave afrikane nëpër rrugë, shpatullat e tyre, lëkurat e shndritshme të shpinës, etj.

Ndërsa, ajo që lë mbresa në kujtesën e tij janë barqet e kërcyera, kërrthizat e dala si një gur zalli nga varfëria e madhe që sundonte në këtë rajon. Në Afrikë, pandrojtësia e trupave ishte e mrekullueshme, sepse jepte një ndjenjë lirie, shumëzonte ndijimet dhe ndihmonte në lidhjet njerëzore rreth tij. Fshati që jetoi në fillim ishte Ogoja. Përshkrimin e këtij fshati, Le Clézio e bën në mënyrë perfekte. Ajo që ndeshet në fillim është rrethimi nga ana e fëmijëve të fshatit, kur ata për herë të parë shohin një fëmijë të bardhë, siç ishte Le Clézio. Afrika për të ishte më tepër trupi sesa fytyra (Clézio, 2009, 12).

Liria në Ogoja ishte e kundërta e jetës që e kishte kaluar në apartamentin në Nicë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, ku jetonin gjashtë persona në dy dhoma. Në Ogoja ata kishin kasolle me kopsht në të cilin kishin të mbjellë pemë frutore si mango, papaja, portokalla e limona. Diku pas kasollës, në mes të kaçubave, në një kotec i mbanin bashkë pulat dhe gjelat e detit, që ishin në vëzhgim të vazhdueshëm nga shpendët grabitqarë e të cilët babai i tij, ndonjëherë, i qëllonte me karabinë për t'i larguar. Anash kasollës ishte shtëpia e të punësuarve që e mbanin titullin *garden boy* dhe kuzhinierit i cili përgatiste ushqime nga kuzhina afrikane.

Autori, gjithnjë, e krahasonte natyrën e Ogojës me natyrën e Nicës, këtu dhuna nuk ishte prezente, por sëmundjet e ndryshme që ishin të përhapura në Afrikë. Natyra përreth dhe në Ogoja ishte e paparashikuar, kishte stuhi të tilla që asnjëherë nuk mund t'i shihte në një vend tjetër, qiell i zi me vetëtimë që dëgjoheshin me kilometra, erëra që rrëzonin drunjtë e mëdhenj, që shkulin palmat, etj. Në krahasim me shumicën e anglezëve që shërbenin në koloni e të cilët, ushtronin funksione administrative si ushtarakë, gjykatës, oficerë distrikti, babai i tij ishte përgjegjës i spitalit dhe i vetmi mjek në atë provincë në shërbim të popullit afrikan. Në një rajon të tillë aq të gjerë, ai i kryente të gjitha shërbimet mjekësore, duke filluar nga lindja e foshnjave deri tek autopsitë (Clézio, 2009, 17).

Pjesa e dytë e këtij romani mban titullin *Termite, Milingona e të tjera*. Në këtë pjesë, ai rrëfen për fushat e gjëra e të rrafshta që ishin përballë shtëpisë. Pas kalimit të kufirit të kopshtit fillonte fusha e gjerë me bimë që shtrihej deri në lumin Aiya. Mosprezenca e babait gjatë ditës i lejonte Le Clézio-s dhe vëllait të tij të hulumtojnë vendet, fushat dhe pyjet përreth fshatit ku jetonin ata. (Clézio, 2009, 24). Gjatë ditës bashkë me vëllain e tij vraponin pa u ndalur nëpër fushat e gjëra dhe pasi që kalonin lumin Aiya, vinte një fushë e gjerë e thatë, me copëza muresh të kuqërremtë si një kështjellë me mure të larta. Këto kështjella apo mure të larta mbi dy metra ishin kreshta me termite apo qyteti i termiteve. Këto kështjella i shkatërronin me gurë duke shijuar zërat e ndryshëm që dilnin nga shpellat e vogla.

Të nesërmen këto kështjella menjëherë rindërtoheshin nga ana e termiteve punëtorë. Për fëmijët afrikane termitet ishin të shenjta, sepse ata mendonin se zoti termit kishte krijuar në fillim lumenjtë dhe ishte ai që e ruante ujin për banorët e tokës. Përveç termiteve në Ogoja kishte edhe milingona që ishin insekte përbindëshme, ngase i gërmonin foletë e tyre deri në dhjetë metra thellësi. Për dallim nga termitet, milingonat ishin mizore, të pajisura me ganxha dhe sulmonin këdo që gjendej para tyre. Në Ogoja kishte kudo insekte, por fëmijët dhe njerëzit ishin mësuar të bashkëjetojnë. Çdo natë si një lloj hakmarrjeje e botës shtazore, kasolla pushtoheshin nga tufa të mëdha insektesh fluturake (Clézio, 2009, 36).

Pjesa e tretë, *Afrikani*, nga e cila e ka marrë emrin edhe vetë romani, përshkruan arritjen dhe vendosjen e babait të tij në Afrikë, në vitin 1928, si kirurg, në një zonë të kolonizuar të britanikëve në Nigeri (rrethi i Ogoja-s) dhe Kamerun (rrethi i Bansa-s). Në vitin 1939, kur filloi lufta, gruaja e tij ishte nisur për në Bretanjë, për të sjellë në jetë djalin e tyre. E mbërthyer në Evropë nga ngjarjet e luftës, ajo nuk ishte në gjendje të kthehej tek burri i saj (Clézio, 2009, 39). Teksti merr formën e një haraçi për këtë njeri sekret dhe të panjohur, por mund të lexohet po aq mirë sa një fragment i autobiografisë së shkëputur.

Fotot e marra nga babai dhe kujtimet personale të tij sjellin në sipërfaqen e kujtesës së shkrimtarit jo vetëm fëmijërinë afrikane, por edhe kujtime dhe përvoja të shumta. Ai do ta kapërcejë Saharanë, do të arrijë në Algjeri, ku pikësynimi i tij ishte Franca, por do të pengohet nga regjimi gjerman dhe do të kthehet përsëri në Afrikë. Familja e tij do ta pres me ankth gjatë një periudhë prej tetë vitesh. Shtrohet pyetja pse, pikërisht, Afrika? I lindur në Mauritius, i shtyrë nga ngjarjet dhe historia, ai studioi mjekësi në Londër, përpara se të hidhte poshtë ngurtësinë e shpirtit borgjez anglez dhe të godiste drejt Guajanës Britanike.

Për më shumë se njëzet vjet ai do të jetë i vetmi mjek në territore të mëdha dhe mbante barrën e përkujdesit për shëndetin e mijërave njerëzve. Ai kishte mbaruar studimet për mjekësi në spitalin Saint Joseph në Londër. Meqenëse ishte bursist i qeverisë britanike, ishte i detyruar që të kryente një punë për bashkësinë (Clézio, 2009, 42). Pasi që caktohet të punojë në departamentin e sëmundjeve tropikale në Southampton, nga Ministria e Kolonive, dërgohet të punojë në Georgetown të Guajanës. Për Le Clézio e takon babain e tij, për herë të parë, në Ogoja, më saktë në pistën e gjatë të Port Harcourt-it. Nën shiun e rrëmbyeshëm, ai i mori me veturën e tij Ford V8.

Jeta e vështirë gjatë luftës në Nicë, kequshqyerja, mbyllja për një kohë të gjatë në banesë, kishte ndikuar negativisht në zhvillimin psikologjik të Le Clézio-s. Dhimbjet e forta të kokës, aq të padurueshme, ushqimi i keq, pothuajse do t'ia kishin marrë jetën në moshën trevjeçare (Clézio, 2009, 47). Bombardimi i portit të Nicës, jeta në fshatin malor ku qëndronin të fshehur me nënën dhe gjyshen e tij, për shkak se babai i tij ishte pjesë e ushtrisë britanike, ishin gjërat e hidhura të jetës në Francë. Udhëtimi për në Afrikë, apo jeta në Ogoja do t'u japë fund migrenave të tmerrshme e tërbimeve të fëmijërisë së tij.

Ky libër, ndërsa vendos kufijtë e aktit fotografik, megjithatë ilustron, ose më saktë shoqërohet, nga një përzgjedhje e fotografive afrikane të babait. Kjo shpreh qartë çështjen thelbësore të rolit dhe kuptimit të futjes së këtyre imazheve në një tekst, që mund të kishte bërë edhe pa to, duke i zbritur në një rol të thjeshtë të burimit të frymëzimit dhe përkujtimit paraprak të aktit. Ai e urren thellë sistemin kolonial, kështu që kur vendoset në Afrikë, ai është i lumtur me rastin e emërimit të tij nga administrata ushtarake në një zonë larg bregdetit, në zemër të një vendi ku distancat maten në orë ecje dhe jo në kilometra.

Në pjesën e katërt të romanit me titull *Nga Georgetown në Victoria*, Le Clézio na përshkruan pikënisjen e jetës së babait të tij. Në moshën tridhjetëvjeçare, babai i tij e braktis Southamptonin dhe me një anije tregtare nis për në Georgetown të Guajanës britanike. Në vitin 1919, ditën e Vitit të Ri, ai bashkë me familjen e tij dëbohen nga shtëpia stërgjyshore në Maurice (Clézio, 2009,

49). Ky dëbim la mbresa të këqija në kujtesën e tij, dhe vendosi që të ikë sa më larg dhe mos të kthehet kurrë më në Maurice. Në të vërtetë Guajana Britanike ishte në anën tjetër të botës, shumë larg ishujve Maurice. Pas largimit nga Maurice në vitin 1919, familja e tij ishte rrënuar si materialisht ashtu edhe moralisht.

Më pas ai vendoset në Angli, pikërisht në Londër ku studioi për shtatë vite me radhë, fillimisht në një shkollë inxhinierësh, pastaj në fakultetin e mjekësisë. Ishte bursist i qeverisë britanike, dhe nuk mund t'ia lejonte vetës të dështonte. Pas mbarimit të studimeve, u specializua në mjekësi tropikale. Në ndërkohë, shkoi ta vizitojë xhaxhain e tij në Paris, ku takoi kushërirën e tij të parë, nënën e Le Clézio-s. Pasioni që ndjeu për të do t'i bëjë të paharrueshme ato pushime. Xhaxhai i tij dhe babai kishin lindur në të njëjtën shtëpi, ku edhe ishin rritur.

Ndërsa nëna e tij kishte lindur në Milly, por kishte dëgjuar për të kaluarën e babait në Maurice (Cortanze, 2004, 68-70). Pasi që zyra koloniale e kishte caktuar si mjek në lumenjtë e Guajanës Britanike, më të mbërritur atje, në një anije apo pirogë, i shoqëruar nga ekipi mjekësor si infermierët, piloti, udhërrëfyesi dhe përkthyesi, ai do të lundrojë për të shëruar njerëzit në rjedhjat e lumenjve si Mazaruni, Essequibo, Kupurung dhe Demerara.

Gjatë qëndrimit në Guajanë do t'i mbeten në memorie dy fëmijët e vegjël që i takon në grykëderdhjen e Demerarës, një djalë i vogël rreth gjashtë vjeç dhe motra e tij pak më e madhe, me barkun e fryrë nga parazitoza. Këto imazhe nuk do të jenë të vetmet që do t'i mbante mend nga Guajana, fatkeqësisht do të ketë edhe shumë të imazhe tjera të një bote të egër, ku sundojnë sëmundjet, frika, dhuna e shitësve të arit dhe kërkuesve të thesarit, si edhe dëgjimi i këngës së dëshpërimit të botës amerindiane e cila ishte në zhdukje e sipër.

Ishte Guajana britanike që e përgatiti babain e Le Clézio-s për në Afrikë (Clézio, 2009, 54). Britania e Madhe pas Luftës së Parë Botërore kishte marrë përsëri nga Gjermania vendet e Afrikës Perëndimore që përfshinte lindjen e Nigerisë dhe perëndimin e Kamerunit. Në fillim të vitit 1928, ai udhëtoi me një anije që zbriste përgjatë brigjeve të Afrikës në drejtim të Victorias, mbi gjirin e Biafras (Clézio, 2009, 55). Në këtë kohë ai kishte tridhjetë e dy vjet. Edhe vëllai i tij Eugène, i cili kishte qenë mjek përpara tij në Afrikë, i kishte treguar se s'do ta kishte aq lehtë në këtë vend.

Pjesa e pestë titullohet *Banso*, sipas vendit ku kishin jetuar. Në vitin 1932 prindërit e Le Clézio-s braktisën shtëpinë në Forestry House në Bamenda dhe u vendosën në mal, në Banso, aty ku duhej të ndërtohej një spital. Ishte vendi i fundit ku ushtrohej autoriteti britanik. Tash, në kompetencat e tij si mjek, do t'i jepej një sipërfaqe më e madhe për ta kontrolluar të gjithë popullatën që jetonte në këtë pjesë. Këtu ai do të qëndrojë më shumë se pesëmbëdhjetë vjet. Vendi ku do ta ushtronte veprimtarinë e tij nuk ekzistonte në hartë. E vetmja hartë e shtypur për këtë zonë ishte harta e ushtrisë gjermane në shkallë 1:300.000, e përpiluar më 1913 (Clézio, 2009, 71).

Njerëzit që jetonin në këtë vend asnjëherë nuk kishin parë evropianë, vetëm më të moshuarit e kujtonin tmerrin e pushtimit të ushtrisë gjermane gjatë pushtimit të Afrikës, apo më qartë gjatë kolonizimit të Afrikës nga ana e evropianëve. Të gjitha udhëtimet për të kryer vizitat mjekësore në vendet e pashkelura nga evropianët, babai i bënte nën shoqërimin e nënës së Le Clézio-s. Koha në Banso, për këtë çift ishte koha e rinisë, e aventurës. Afrikën që e hasin ata nuk ishte ajo e kolonizimit. Kur vizitonin fshatrat e ndryshëm ata priteshin me nderime nga mbretërit, siç ishte rasti edhe gjatë vizitës së mbretit Memfoi të Bansos.

Nganjëherë, gjatë rrugës së tyre përmes maleve, netët ishin të dhunshme. Ata merrnin pjesë në festa që shpërthenin befas nëpër fshatra, si ajo në Babungo, ku distanca nga Banso ishte katër ditë rrugë. Festa fillonte me femrat që kërcenin të zhveshura, që luanin apo me këmbët e tyre rrihnin dheun me të njëjtin ritëm, si tamburët. Festa fillonte me perëndimin e diellit, rreth orës gjashtë dhe zgjaste deri në agimin e së nesërme. (Clézio, 2009, 77).

Pjesa e gjashtë e romanit është *Ogoja e tërbuar*. Gjatë qëndrimit në Forestry House, prindërit e Le Clézio-s e shijonin lumturinë dhe lirinë e Afrikës. Në këtë kohë, nëna e tij mbeti dy herë shtatzënë. Afrikanët thonë se njerëzit nuk lindin ditën kur dalin nga barku i nënës, por në vendin dhe çastin e ngjizjes së tyre (Clézio, 2009, 79). Në këtë kohë ndihmësi i babait të tij ishte plaku Ahido, që ishte edhe këshilltari dhe miku më i mirë i babait të Le Clézio-s. Ai merrej me gjithçka rreth organizimit dhe ndihmës së punës së babait, si me furnizimet, rrugën që duhet ndjekur vendeve të largëta, marrëdhëniet me prijësit, pagat e hamejve.

Gjatë njëzet viteve që kishte kaluar në perëndimin afrikan, babai kishte vetëm dy miq, plakun Ahidjo dhe doktor Jeffries një oficer diskrikti në Bamenda i cili ishte i pasionuar pas arkeologjisë dhe antropologjisë. Plaku Ahidjo i kishte shkruar rregullisht shumë vite babait të Le Clézio-s edhe pas kthimit të tij Francë. Në vitin 1960 Ahidjo e kishte pyetur atë lidhur me bashkimin e mbretërive të Perëndimit me Nigerinë. Pastaj letrat ishin rralluar dhe ndërprerë. Babai kishte marrë vesh nga murgeshat e Bamendas se miku i tij i vjetër Ahidjo kishte vdekur.

Ishte lufta ajo që e theu ëndrrën afrikane të babait të Le Clézio-s. Më 1938, nëna e tij e braktisi Nigerinë dhe u vendos pranë prindërve të saj në Francë, me qëllim që atje ta lindë vëllanë e Le Clézio-s, Eugène-in. Babai kishte marrë pushim për lindjen e fëmijës së parë, gjë që e shtyu të ngjitej deri në Bretagne, ku do të qëndronte deri në fund të verës së vitit 1939. Lufta e Dytë Botërore shpërtheu menjëherë pasi Le Clézio-s u largohet për në Ogoja. Ai e dinte se kjo luftë do ta përflakte përsëri Europën, siç ndodhi edhe në vitin 1914 (Clézio, 2009, 82). Me arritjen e lajmeve për pushtimin e Francës në qershor të vitit 1940, ishte tepër vonë për të vepruar.

Nëna e Le Clézio-s gjendej në Bretagne, akoma nuk e kishte marrë veten nga lindja e Le Clézio-s. Urdhri i ushtrisë gjermane ishte që të gjithë banorët e përhershëm të Bretagne-s të largohen. Nga ana tjetër babai nuk kishte asnjë lajm se çka ndodhte në Francë, i vetmi burim ishin lajmet që i jepte BBC. Pikërisht për këtë arsye ai provon një aventurë të çmendur, duke kaluar shkretëtirën e Saharasë për të arritur në Algjeri e që më pastaj të kalojë në Francë, me të vetmin qëllim që të shpëtojë gruan dhe fëmijët dhe t'i marrë me vete në Afrikë.

Por, kur arrin në fortesën Mac-Mahon, në El-Goléa, ku në kohë lufte, çdo i huaj konsiderohej si spiun, e ndalojnë dhe e kthejnë mbrapsht. I vrarë në shpirt, ai kthehet në Ogoja. Pas këtij dështimi, Afrika për të nuk do ta ketë të njëjtën shije lirie për të (Clézio, 2009, 84). Me kthimin në Ogoja, nuk do të ketë më rastin të banojë në shtëpi të bukur si në Forestry House në Bamenda, por në një shtëpi të shëmtuar, me çati llamarine të valëzuar, e cila pasditeve e shndërron shtëpinë në një furrë nga vapa që bënte në Ogoja. Ai jeton në këtë shtëpi gjatë viteve të luftës, i vetëm, pa asnjë lajm nga fëmijet dhe bashkëshortja e tij. Puna e tij e mjekut kthehet në një sëmundje për të. Nuk do ta bëjë punën e mjekut si më parë, nuk kishte më kohë të flasë, të dëgjojë ankesat e familjeve.

Pas gjithë këtyre viteve, kur ai ndihej pranë afrikanëve, si miku dhe i afërmi i tyre, ai kupton se mjeku nuk është gjë tjetër, veçse një aktor i fuqisë koloniale, i njejtë me policin, gjykatësin apo ushtarin. Pak para se të vdiste, i kishte thënë Le Clézio-s se po ta niste punën nga fillimi, nuk do të bëhej mjek, por veteriner, sepse kafshët ishin të vetmet për ta pranuar vuajtjen e tyre (Clézio, 2009, 87).

Pjesa e shtatë dhe e fundit e romanit është *Harresa*. Pas qëndrimit njëzet vjeçar në Afrikë, ai do të dalë në pension dhe do të kthehet në Francë, por gjithnjë duke i ruajtur shprehitë e profesionit të tij, si ngritjen në ora gjashtë, përgatitjen e mëngjesit veshjen, këpucët e lyera, kapelen mbi kokë, vajtjen në treg dhe kthimin në shtëpi në ora tetë. Verifikonte gjithmonë qymyrin e filtrit të ujit, pinte vetëm çaj dhe ujë të vluar, i lante enët vetë me esencë lulesapuni. Nuk lexonte, por vetëm dëgjonte radio, libri i tij i vetëm ishte *Imitimi i Jezu Krishtit* (Clézio, 2009, 94). Në kontaktin e parë, Le Clézio dhe vëllai i tij u ndeshën me disiplinën e ashpër të babait të tyre. Befas ata mësuan se babai ishte i tmerrshëm, sa që shkonte të nxirrte një thupër për t'i rrahur ata.

Kishte filluar ta praktikonte fenë dhe kërkonte që lutja të bëhej për çdo mbrëmje para gjumit dhe, ishte pajisur me një besim pa bestytini, siç e kishte gjetur në shembullin e Islamit. Ai kishte neveri për mishin e derrit, kështu që mënyra e tij e ngrënies ishte zierja e orizit sipas metodës afrikane, konsumi i frutave të thata si hurmat e Arabisë, fiqtë dhe bananet që i nxirrte të piqeshin nën diell (Cortanze, 2004, 68-70).

Në vitin 1968 në Nigeri ndodh një prej gjenocideve më të mëdha të shekullit, e njohur me emrin Biafra. Për të marrë në dorë pusët e naftës, shoqëritë e mëdha të naftës si Shell-British Petroleum ndikuan në fillimin e luftës civile në këtë vend. Kjo luftë ndërmjet qytetërimesh, u bë më pas si një luftë midis krishterëve dhe myslimanëve, apo mes nacionalistëve dhe kapitalistëve. Kur i pa këto ngjarje babai, në vendin ku kishte kaluar pjesën më të madhe të jetës, ai ra në një dëshpërim të madh. Në moshën shtatëdhjetë e dy vjeçare u shtrua për një kohë të shkurtër në spital nga një grip i lig.

Pikërisht, në vitin kur u shfaq murtaja e re e sidës e cila e kërcënoi një të tretën e popullsisë së përgjithshme të Afrikës, vdes edhe babai i Le Clézio-s. Nga ana e kombeve perëndimore nuk luftohet aspak kjo sëmundje, për fat të keq ata shtiren sikurse nuk dinë asgjë. Sot, megjithëse ekziston, udhëton, ka krijuar familje, Le Clézio, në çdo çast, si një substancë ajrore që qarkullon ndërmjet faqeve të realitetit, ai përsëri kujton Ogojën. Tek e fundit, ndoshta ëndrra e tij e vjetër nuk e mashtronte. Nëse babai i tij ishte bërë Afrikan, thjesht nga forca e fatit të vet, atëherë ai mund të mendojë për nënën e tij afrikane, ajo që e ka përqafuar dhe ushqyer në çastin kur është ngjizur, në çastin kur ka lindur (Clézio, 2009, 110).

3. Përfundimi

Një numër i madh i veprave të Le Clézio kanë lidhje direkte me faktet historike, duke u bazuar në ngjarje të vërteta që kanë ndodhur gjatë epokave të ndryshme të njerëzimit, si dhe gjatë jetës së tij, babait të tij te romani *Afrikan*, ndërsa jetëpërshkrimin e nënës së tij e paraqet te romani *Ylli endacak*. Romani autobiografik *Afrikan* është një rrëfim i dy protagonistëve, pra i babait të Le Clézio-s dhe vetë autorit. Nëpërmjet jetës së babait, ai i paraqet edhe përjetimet e tij gjatë periudhës së kaluar në Afrikë.

Roli i mitit në letërsinë e Le Clézio-s, është i pashmangshëm, e të mos përmendim ndodhitë nëpër kohë që kanë lënë gjurmë në letërsinë e tij, që nga fëmijëria e tij e deri në ditët e sotme. Ai është ende aktiv me shkrimet e tij. Duhet përmendur udhëtimin e tij të parë për në Afrikë, kontaktet e tij të para me kulturat afrikane, me peizazhin e thatë të Afrikës, kontaktin e tij me shkretëtirën. E gjithë kjo do të lë gjurmë në mendjen dhe shpirtin krijues të Le Clézio-s (Cortanze, 2009, 95).

Kronologjia e rrëfimeve që i jep në veprat apo romanet e tij, në rrëfimet e para që ai i dëgjon nga gjyshja e tij, e që kanë të bëjnë me udhëtime dhe ngjarje nga më të ndryshmet, të përjetuara nga stërgjyshërit e autorit të cilët e kishin, gjithashtu, shpirtin e nomadit, është mjaft tërheqëse dhe mbresëlënëse. Pastaj, duhet me rëndësi të veçantë është kontakti i si i vogël me librat në bibliotekën familjare. Ndikim më të madh te Le Clézio kanë edhe rrëfimet e të atit për udhëtimet e tij para familjarëve të cilat zgjonin kureshtjen e tyre. E gjithë kjo e nxit Le Clézio-n që të bëjë një jetë të ngjashme me atë të një nomadi, duke jetuar në Albuquerque, Nicë dhe Paris, por edhe duke mos u ndalur së udhëtuari nëpër botë (Salles, 1999 84).

Në moshë të re, Le Clézio do të eksplorojë Afrikën, ndërsa si i rritur ai do të udhëtojë për në Amerikën Latine, ku për një kohë jo të shkurtër do të ndalet në Meksiko, me qëllim që të studiojë historinë e popujve amerindianë. Miti është si një pikësynim i shumicës së romaneve të Le Clézio-s, që prek kulturat edhe perceptimet e miteve në shumë vende të ndryshme të botës, ndërsa është historia është ajo që e ndjek në shumicën e romaneve.

Referencat

- [1]. Anoun, A. (2005). *J. M. G. Le Clézio, Révolutions ou l'appel intérieur des origines*. Paris: L'Harmattan.
- [2]. De Cortanze, G. (2009). *J.M.G. Le Clézio*. Paris: Gallimard.
- [3]. De Cortanze, G. (2004). *Mon père l'Africain*. Paris: Magazine littéraire.
- [4]. Eliade, M. (1996). *Mythes, rêves, mystères*. Paris: Gallimard.
- [5]. Eliade, M. (2019). *Miti dhe realiteti*. Tiranë: Pika pa sipërfaqe.
- [6]. Jauss, H.R. (1978). *Pour une esthétique de la réception*. Paris: Gallimard.
- [7]. Le Clézio, J.M.G. (2004). *L'Africain*. Paris: Mercure de France.
- [8]. Le Clézio, J.M.G. (2009). *Afrikani*. Tiranë: Skanderbeg Books.
- [9]. Lévi-Strauss, C. (2009). *Mythe et signification*. Paris: Seuil.
- [10]. Salles, M. (1999). *Étude sur Le Clézio : Désert*, Paris: Ellipses.
- [11]. Roussel-Gillet, I. (1999). *J. M. G. Le Clézio, écrivain de l'incertitude*, Paris: Ellipses.
- [12]. Visoka, A. (2011). *Koha e shkrimit*. Prishtinë: 99-AIKD.
- [13]. Visoka, A. (2016). *Shkrim dhe receptim*. Prishtinë: Faik Konica.